

## **DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**

### **Sillabuset e moduleve**

#### **Kurrikula: Gjuhë Frënge**

#### **Drejtimi: Gjuhë, letërsi dhe Qytetërim francez**

### **VITI I PARË**

#### **01. Gramatikë e Gjuhës A (Morfologji&Sintaksë)(GGJA)**

##### **a. Morfologji e Gjuhës A**

##### **Objektivat e kursit:**

Morfologjia e gjuhës shqipe synon plotësimin e njohurive rreth morfologjisë, objektit, pjesëve të ligjëratës, kuptimeve dhe formave gramatikore, si dhe lidhjet e saj me disiplinat e tjera gjuhësore.

##### **Programi:**

Objekti i morfologjisë. Lidhjet e saj me fonetikën dhe sintaksën.  
Lokucionet.

Fjala dhe morfema. Analiza morfemore dhe analiza fjalëformuese.

Emri. Grupet leksiko-gramatikore të emrave.

Mbiemri. Klasifikimi kuptimor dhe morfologjik i mbiemrave.

Përemri. Klasifikimi i përemrave.

Folja. Zgjedhimi i foljeve. Zgjedhimi jovepror.

Ndajfolja. Shkallët e ndajfoljes.

Parafjala. Klasifikimi i parafjalëve sipas strukturës morfologjike dhe sipas kriterit dhe kuptimet kryesore të tyre.

Lidhëza. Klasifikimi i lidhëzave sipas strukturës morfologjike dhe sipas funksionit sintaksor.

Pjesëza.

Pasthirrma.

##### **Bibliografi:**

Akademia e shkencave e R.Sh. *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sintaksa II, Tiranë, 1997.

Literatura e shënuar në bibliografinë e tekstit.

Gramatika e gjuhës shqipe I , Akademia e shkencave ; Tiranë 2002

1998-Recencen mbi librin e Prof.Dr.Gjovalin Shkurtaç, a) “*Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën shqipe*”, botuar në gazetën “Rilindja e Kosovës”.

1999-2000-Recencen mbi librin e Prof.Dr.Ethem Likajt, “*Format analitike në gjuhën shqipe*”, botuar në revistën “*Studime filologjike*”, numrat 3-4.

b)“Mbi disa struktura sintaksore modale dhe funksionet pragmatike të foljeve përbërëse”.Prishtinë, 2002

c)“Diateza në gjuhën shqipe. Përfaqje në kuadrin e teorisë së valencave të foljeve.”.Prishtinë, 2005

d)“*Edhe njëherë rreth disa çështjeve të fjalëformimit. Nocioni i kokës.*” Korrik 2008 Konferencë e organizuar për nder të 100 vjetorit të Prof.Dr. Eqrem Cabejt.

##### **b. Sintaksa e Gjuhës A**

### **Objektivat e kursit:**

Sintaksa e gjuhës shqipe synon plotësimin e njohurive rreth sintaksës si një disiplinë më vete gjuhësore, objektit, raporteve sintaksore; njësive sintaksore, si dhe lidhjet e saj me disiplinat e tjera gjuhësore dhe jashtëgjuhësore.

### **Programi:**

Lindja e sintaksës si disiplinë gjuhësore më vete dhe historia e studimeve sintaksore të gjuhës shqipe .

Lidhja e sintaksës me disiplinat e tjera gjuhësore dhe jashtëgjuhësore.

Togfjalëshi dhe sintagma si njësi sintaksore.

Fjalësi si njësi sintaksore.

Tipologjia e fjalëve në gjuhën shqipe.

Fjalitë dykryegjymtyrëshe dhe fjalitë njëkryegjymtyrëshe në gjuhën shqipe.

Gjymtyrët e dyta të fjalisë, kundrinori, rrethanori, përcaktori etj..

Periudha dhe fjalësi e përbëra, si njësi sintaksore në gjuhën shqipe.

### **Bibliografi:**

Akademia e shkencave e R.Sh , *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sintaksa II, Tiranë, 1997

Thoma Dhima, *Sintaksa*, Tiranë, 2005

Mehmet Çeliku, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007

Menella Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Tiranë, 2000

Rami Memushaj, *Gramatika gjenerative*, Tiranë, 2003

Josif Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Prishtinë, 2005

## **02. Gjuhë praktike e Gjuhës B (GJPGJB-GJF)**

### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs synon të kuptuarit, të shprehurit në gjuhën e folur dhe të shkruar. Siguron sistematikën e njohurive gjuhësore; leksik, gramatikë dhe drejtshkrim. Programi ofron një gamë mjaft të gjërë ushtrimesh që lidhen me katër aspekte: të kuptuarit, leksikun, të shprehurit dhe gramatikën.

### **Programi:**

Niveli i propozuar karakterizohet nga një tematikë që përmbledh situata të përzgjedhura të karakterit universal të cilat shënojnë një hap drejt njohjes së realiteteve të shoqërisë franceze. Tematika synon pasurimin dhe përvetësimin e leksikut në përputhje me ecurinë gramatikore.

Nocionet themelore të fonetikës

Nocionet themelore të leksikut

Nocionet themelore të gramatikës

Nocionet themelore të drejtshkrimit

### **Bibliografi :**

Metoda “ Le Nouveau sans Frontieres” Vëll 1, CLE International.

Metoda “ Le Nouveau sans Frontieres” Vëll 2, CLE International.

Dictionnaire des Verbes Français. J et J.P Caput, Larousse, Paris.

Le Grand Dictionnaire des Synonymes. Fernand Nathan, P. Macé/ M. Guinard.

### **03. Gjuhë B e folur**

#### **Objektivat e kursit:**

Kjo lëndë ka si qëllim të nxisë studentët të bashkëbisedojnë në frëngjisht, duke u ofruar atyre mjetet dhe mënyrat e komunikimit gojor. Fjalori tematik i zgjedhur, nga njëra anë, ka si qëllim të përforcojë njohuritë e tyre, dhe nga ana tjetër, të zgjerojë bagazhin leksikor. Theksi është vënë më shumë në rubrikën kryesore “ Si të shprehemi”. Pra, në këtë mënyrë, studentët nxiten të shprehen lirshëm në frëngjisht, duke u vënë në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për t’ia arritur qëllimit.

#### **Programi:**

Koha e lirë dhe pushimet  
Muzika  
Moda dhe veshjet  
Kinemaja  
Sporti  
Kuzhina dhe ushqimet  
Qyteti  
Banesat  
Jeta shkollore  
Shtypi  
Reklama  
Drejtësia  
Mjekësia  
Politika  
Ekonomia

#### **Bibliografi:**

Raul LILO, "*Communiquons en français*", 1997, Libri Universitar, Tiranë.  
Yves Cortez, "*Le français que l'on parle*", 2002, L'Harmattan, Paris.

### **04. Gjuhë C (1)**

**Objektivat e kursit:** Ky kurs ka për qëllim t’u japë studentëve elementët e nevojshëm të gjuhës se huaj sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve (sipas niveleve A1, A2, B1, B2, C1, C2).

#### **Programi:**

##### *Dëgjimi*

Nxënësit shprehin kuptimin duke reaguuar ndaj urdhrave, pyetjeve ose pohimeve të shkurtra e të thjeshta që shqiptohen në kushtet e klasës. Si edhe duke reaguuar drejtpërdrejt ndaj udhëzimeve dhe urdhrave të përcjella gojarisht me fjali të thjeshta nga situata dhe tema të përditshme dhe me shpejtësi pothuaj normale

##### *Të folurit*

Nxënësit arrijnë ti shqiptojnë fjalët në mënyrë të përafërt me mbështetje gojore, ose vizuale dhe të reagojnë me faza të shkurtra ndaj shtysave të klasës, duke emërtuar ose përshkruar njerëz, vende, objekte apo situata.

### *Të lexuarit*

Nxënësit shprehin kuptimin e fjalëve të veçanta, duke ua përshtatur tingujt germave dhe duke lexuar me zë të lartë fjalë dhe fraza të njohura të veçanta. Nxënësit shprehin kuptimin e teksteve dhe dialogëve të shkurtër, të ndërtuar me një fjalor të njohur.

### *Të shkruarit*

Nxënësit kopjojnë saktë fjalë ose fraza të shkurtra të njohura, etiketojnë objekte rrethana, dallojnë dhe përzgjedhin fjalë të përshtatshme për të plotësuar togfjalësha. Nxënësit shkruajnë me ortografi të kuptueshme fraza të ngulitura për tema të njohura.

## **Bibliografi:**

## **05. Informatikë**

### **Objektivat e kursit:**

Lënda “Informatikë Softwar Aplikative” ka synim kryesor të pajisë studentët me njohuri të përgjithshme mbi shkencën e kompjuterave, si dhe me njohuri më të thelluara në lidhje me *software-t* aplikativë kryesorë në përdorim të përgjithshëm, analizën e efikasitetit të tyre dhe përdorimin e tyre në fusha të ndryshme studimi.

### **Programi:**

Nëpërmjet zhvillimit të orëve të leksioneve dhe laboratorëve synohet që studentët të marrin njohuritë e nevojshme në përdorimin e software-ve aplikativë. Në fund të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të fitojnë njohuritë bazë në lidhje me:

Përdorimin e Word-it për përpunimin e dokumentave tekst.

Përdorimin e spreadsheet-eve për përpunimin e të dhënave.

Krijimin e prezantimeve të ndryshme.

Përdorimin e Outlook për administrimin e punëve.

## **Bibliografi:**

B. Ruseti, *Informatika për Fakultetin e Ekonomisë*, 2007.

Gretchen Douglas, Mark Connell, *Fundamentals of Ms Office*, 2007.

Leksione të shtypura.

## **06. Lëndë me Përzgjedhje**

### **01. Metodologji e punës kërkimore**

### **Objektivat e kursit:**

Kjo lëndë synon t’u japë studentëve bazat e punës universitare në lëndë të ndryshme si gramatikë, analizë teksti, sintaksë, etj.

Programi:

Parimet bazë të gramatikës (ushtrime)

Morfologji leksikore

Shpjegim teksti

Puna me fjalorët.

## **Bibliografi:**

Grup autorësh, “*Grammaire du Français Contemporain*”, Larousse, Paris, 1974

A. Lehmann, "Sémantique et morphologie", Nathan, Paris, 2000.

## **02. Letërsi e Gjuhës A**

### **Objektivat e kursit:**

Kjo lëndë jep një panoramë të përgjithshme të rrymave letrare dhe të kryeveprave të letërsisë shqipe. Lënda rekomandon leximin e veprave të parashikuara në program dhe analizën e tyre nëpërmjet eseve dhe punëve me shkrim nga studentët.

### **Programi:**

Letërsia e vjetër shqipe. Fillimet e letërsisë shqipe. Elementët humanistë tek shkrimtarët e vjetër. Teoria e qarqeve dhe përfaqësuesit e secilit prej tyre.

Letërsia shqipe e Rilindjes. Struktura hapsinore e romantizmit shqiptar, përfaqësuesit kryesorë, ngjashmëritë dhe veçansite e romantizmit shqiptar parë në plan krahasues me atë evropian

Jeronim de Rada, përfaqësues i romantizmit shqiptar. Epizmi, lirizmi dhe dramatizmi në krijimtarinë e tij.

Naim Frashëri, lidhjet me krijimtarinë popullore, lidhjet me letërsinë evropiane me atë perse dhe arabe. Proza dhe poezia filozofike. Poema Bagëti dhe Bujqësi.

Ndre Mjeda, veçoritë poetike në poemat lirike Vaji i Bylbylit dhe I tretuni, poemat tingëllore Liria, Skodra, Lissus dhe në poemën Andrra e jetës.

Faik Konica, Analizë e mendimit të tij kritik letrar dhe të shkollës që themeloi. Proza e tij dhe kontributi i tij në kritikën letrare.

Gjergj Fishta, veprimtaria e shumanshme e tij. Lirikat, melodramat si dhe kontributi i shkrimtarit në dramaturgjë. Veçoritë artistike të Lahutës së malësisë.

Fan Noli, si shkrimtar, kritik letrar, shqipëruar, historian dhe politikan. Veçoritë poetike të përmbledhjes poetike Albumi.

Mitrush Kuteli, proza rrëfimore e tij. Ndikimi nga tradita si dhe moderniteti në krijimtarinë e tij.

Lasgush Poradeci, tipare të modernitetit në poezinë e tij, veçoritë artistike të krijimtarisë poetike të Lasgushit.

Ernest Koliqi, krarakteristika të prozës artistike. Kontributi i veçantë i Koliqit në studimet historike – letrare. Veshtrimi psikonalitik i fenomeneve jetësore në disa prej novelave të tij.

Migjeni, krarakteristika të poezisë dhe prozës. Modernizmi në stilin lakonik, dhe simbolik të prozave të Migjenit.

Krijimtaria romanore e Petro Markos: humanizmi, utopizmi, elementet e realizmit, sentimentalizmit në romanet e tij.

Krijimtaria e Dritëro Agollit, tiparet dhe risi të rrëfimit, humori, grotesku në aftësinë për të paraqitur dukuri të ndryshme të realitetit njerëzor.

Krijimtaria e Ismail Kadaresë: simbioza e realizmit dhe e modernitetit bashkohor. Universaliteti dhe origjinaliteti i veprave të tij. Përthyerja e kohëve, simbolika, alegoria grotesku dhe krijimi i personazheve arketiporë si krarakteristika të një krijimtarie me tipare moderniste.

Veçoritë artistike dhe veçansitë e procesit krijues të shkrimtarit Kasem Trebeshina. Larmia e krijimtarisë në lloje letrare dhe stile. Disidenca, estetika e përmbysur, grotesku absurdi dhe përmasa e katërt në prozën dhe dramën e tij.

### **Bibliografi:**

Këngët e Milosaos – De Rada  
Bagëti e Bujqësi – N. Frashëri

Andrra e jetës - Mjeda  
Lahuta e malësisë – Fishta  
Dr. Gjilpëra- Konica  
Albumi – Noli  
E madhe është gjëma e mëkatit – Mitrush Kuteli  
Vallja e yjeve – Lasgush Poradeci  
Tregëtar flamunjsh - Ernest Koliqi  
Qyteti i fundit – Petro Marko  
Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo – Dritro Agolli  
Pallati i ëndrrave – I. Kadare  
Odin Mondvalse – Kasem Trebeshina

### **03. Gramatikë frënge e aplikuar**

#### **Objektivat e kursit:**

Kjo lëndë synon të forcojë dhe të thellojë njohuritë e studentëve në aplikimin e rregullave të ndryshme gramatikore lidhur me përdorimin e gjuhës frënge si dhe të plotësojë boshllëqet që ata paraqesin gjatë aplikimit të këtyre rregullave me qëllim që ata të komunikojnë sa më rrjedhshëm e ta përdorin sa më korrektësisht këtë gjuhë.

#### **Programi:**

Nyja shquese, jo shquese  
Mbiemrat dhe përemrat pronorë  
Mbiemrat dhe përemrat dëftorë  
Përemrat vetorë  
Përemrat e pacaktuar  
Përemrat lidhorë  
Ndajfoljet, parafjalët  
Forma veprorë/joveprorë  
Mënyra dhe koha, dëftorja dhe lidhorja  
Ligjërata e zhdrejtë  
Kushti – Hipoteza  
Shprehja e pasojës dhe e shkakut

#### **Bibliografi :**

Ch. Descotes – genon, M-H. Morsel, C. Richou, *L'exercisier, l'expression française pour le niveau intermédiaire*, PUG, flem, 1999 ISBN 2-7061-0451-1  
E. SIREJOLS, *Grammaire, exercices niveau intermédiaire et avance (2 et 3)*, CLE, 1993  
Cdiot- Cueilleron, Frayssinhes, Klotz... *Grammaire, Cours de civilisation Française de la Sorbonne*, HACHETTE F.L.E, 1992

### **04. Sporte**

#### **Objektivat e kursit:**

Kjo lëndë synon përgatitjen fizike të studentëve si dhe angazhimin e tyre në veprimtari të ndryshme sportive.

#### **Programi:**

Basketboll 9 ore

Volejbolli 9 ore  
Futbolli 9 ore  
Hendbolli 6 ore  
Atletike 4 ore  
Gjymnastikë 3 ore

## **07. Morfologji e Gjuhës B (1)**

### **Objektivat e kursit:**

Kursi synon t'i bëjë studentët të ndërgjegjshëm në këtë lëndë bazë të formimit profesional.

### **Programi:**

Njohuri themelore për përvetësimin dhe përdorimin e pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Funksioni fjalëve "terme".

Thellimi i metejshëm i njohurive të fituara më parë nga studentët për dukuritë e ndryshme gramatikore.

### **Bibliografi:**

Grevisse M. – *Le bon usage*, 13-ème édition, Duculot, 1993.  
Riegel M. Pellat J.Ch. Rioul R. – *Grammaire et méthodologie du français*, PUF, 1994.  
Wagner R.-L. Pinchon J. – *Grammaire du français classique et moderne*, Hachette, 1962.

## **08. Fonetikë e Gjuhës B**

### **Objektivat e kursit:**

T'u jepen studentëve njohuritë teorike bazë në fushën e Fonetikës dhe Fonologjisë frënge

T'u jepen studentëve aftësitë e duhura në shqiptimin normativ të gjuhës frënge

Të hidhen bazat për mësimdhënien nëpërmjet fonetikës korrektive

### **Programi:**

Ky kurs ndahet në tri pjesë:

Nocione bazë të Fonetikës frënge: përkufizimi i objektit të studimit, raportet e saj me shkencat e tjera, zbatimet, dy aspektet e Fonetikës: fiziologjike/nyjëtimore dhe akustike. - Raportin midis Fonetikës dhe Fonologjisë.

Kushtet e lindjes dhe zhvillimit të Fonologjisë në kuadrin e gjuhësisë strukturaliste.

Nocione bazë në Fonologji: fonema, variantet fonematike, sistemet fonologjike.

Nocione bazë të Prozodisë së gjuhës frënge: fenomenet intonative, ritmike dhe theksi në gjuhën frënge.

Sistemet e transkripimit fonetik

### **Bibliografi :**

Lagji K., *Éléments de phonétique et de phonologie du français*, Cycle de cours destinés aux étudiants du Département de français, Shtëpia Botuese Violette.  
Martinet A., *La prononciation du français contemporain*, 1945, Paris, Droz, 2e édition, 1971

Carton F., *Introduction à la phonétique du français*, 1974, Bordas

## **09. Hyrje në Gjuhësi**

### **Objektivat e kursit:**

Lënda synon të japë nocionet bazë të gjuhësisë së përgjithshme dhe ta përgatisë studentin për të ndërmarrë pa vështirësi studimin e lëndëve të tjera gjuhësore.

### **Programi:**

Lënda jep nocionet bazë të gjuhësisë, në mënyrë që studenti të bëjë analiza gjuhësore për tekstet në gjuhën frënge. Programi përmban teori dhe ushtrime praktike për ndërgjegjësimin gjuhësor të studentit në gjuhën frënge, si dhe të dhëna për origjinën e gjuhës, njohjen, natyrën, funksionin, strukturat gjuhësore, simbolet gjuhësore si dhe marrëdhëniet e saj me folësit, me kulturën.

### **Bibliografi:**

Baylon, Fabre, *Iniciation à la linguistique*, Nathan.  
Cikël leksionesh përgatitur nga titullari i lëndës

## **10. Gjuhë B e shkruar**

### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs synon përfitim të njohurive dhe strategjive bazë për të arritur në një kuptim të saktë të gjuhës të shkruar dhe në mënyrë të veçantë përshtatjen me mënyrat e ndryshme të komunikimit në fushën akademike dhe profesionale duke sensibilizuar studentët për funksionimin gjuhësor dhe kulturor të llojeve të ndryshme të teksteve, duke propozuar një përqasje të teksteve nga gjuha e përditshme deri në atë akademike

### **Programi:**

Ndërtimi i një letre  
CV dhe letër zyrtare  
Si të paraqisësh një mendim  
Si ti përmbledhësh idetë  
Si ti rilidhësh idetë me njëra-tjetrën  
Si të ndërtosh një paragraf  
Përgatitja e një përmbledhje  
Ndërtimi i esesë, analiza e temës, paragrafeve dhe mbylljes.  
Ndërtimi i sintezës, studimi i teksteve, krahasimi i tyre, plani dhe redaktimi.

### **Bibliografi:**

Cikël leksionesh të përgatitura nga pedagogu i lëndës  
*L'écrit, stratégies et pratique*, Aline Gohard Radenkovic, 1995

## **11. Tipologji tekstore (1)**



### **Objektivat e kursit:**

Kursi ka për qëllim t'u japë studentëve elementët e nevojshëm për leximin dhe studimin e teksteve. Ai paraqet teknika dhe strategji të ndryshme që ndihmojnë për analizën dhe komentimin e tipave të ndryshëm të teksteve: narrativ, përshkrues, argumentues, shpjegues, artikull gazete, etj. Lënda i mundëson studentët të shijojnë bukurinë e teksteve, duke synuar të kuptuarit me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim.

### **Programi:**

Njohuri të përgjithshme mbi analizen e teksteve  
Tipologjia e teksteve  
Analizë tekstesh narrativë  
Analizë tekstesh përshkrues  
Analizë tekstesh argumentues  
Analizë tekstesh shpjegues  
Analizë artikujsh gazete

### **Bibliografi:**

Tekste të zgjedhur nga vepra dhe autorë të ndryshëm  
Materiale ndihmëse të përgatitura nga titullari i lëndës  
Tekstet e zgjedhur për t'u studiuar merren nga faqet më të famshme të letërsisë franceze duke e vënë theksin në tekstet bashkëkohorë dhe në materiale të aktualitetit; ato variojnë çdo vit edhe në funksion të dëshirave e preferencave të studentëve.

## **12. Gjuhë C (2)**

### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs ka për qëllim t'u japë studentëve elementët e nevojshëm të gjuhës se huaj sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve (sipas niveleve A1, A2, B1, B2, C1, C2).

### **Programi:**

#### *Dëgjimi*

Nxënësit shprehin kuptimin duke reaguar ndaj pikave kryesore në përshkrimet gojore të mikrokonteksteve ose rrëfimet bazë me ndonjë përsëritje. Ata janë të aftë të shprehin kuptimin e rrëfimeve dhe përshkrimeve të njohura, që kanë lidhje me ngjarje të kaluara, të tashme dhe të ardhme, me ndihmën e përsëritjes dhe të gjeesteve.

#### *Të folurit*

Nxënësit japin përgjigje të shkurtra për ato çka shohin dhe dëgjojnë, duke përdorur fraza të shkurtra për të shprehur veprimet, dëshirat, ndjenjat, qëllimet vetjake. Gjithashtu ata marrin pjesë në skenarë të shkurtër, të parapërgatitur që bazohen në bashkëbisedime të ndërtuara me fraza të ngulitura, që përdoren për të përshëndetur, për të kërkuar ose ofruar ndihmë.

#### *Të lexuarit*

Nxënësit shpërfaqin fillesat e leximit të pavarur, përdorin kontekstin për të interpretuar kuptimin dhe shprehin reagim vetjak ndaj leximit. Nxënësit tregojnë besim në rritje në leximin me zë të lartë dhe në përdorimin e materialit referimor e mbështetës; ata fillojnë të zgjerojnë leximin e pavarur.

#### *Të shkruarit*

Nxënësit shkruajnë fjali te shkurtra, që ndërtohen me një gjuhë të thjeshtë përshkruese dhe shprehin me shkrim ndjenjat dhe reagimet vetjake. Nxënësit shkruajnë paragrafë të shkurtër që përshkruajnë mikrokontekste të njohura, ata janë të aftë të shkruajnë drafte hartimi.

## **Viti II**

### **01. Teori e Letërsisë**

#### **Objektivat e kursit:**

Lënda synon të përcaktojë sa më qartë nocionin “letërsi”. Përcakton raportet e saj me shoqërinë dhe artet e tjera. Studion veprën letrare në tri aspektet e saj: autor-mesazh-receptim. Përcakton raportet e letërsisë me shoqërinë dhe artet e tjera. Përkufizon gjinitë dhe funksionet e figurës letrare. Gjithashtu ky kurs i ndihmon ata të testojnë veten në këtë fushë.

#### **Programi:**

##### *Pjesa e parë:*

Letërsia dhe studimi letrar

Teoria, kritika dhe historia e letërsisë. Funksionet e letërsisë.

Histori e shkurtër e Poetikës nga Aristoteli tek strukturalizmi.

Raporti i historisë me shoqërinë, me filozofinë dhe me artet e tjera

##### *Pjesa e dytë:*

Teksti letrar

Autori/narrator

Letërsia /realiteti/fiksioni/vërtetësia dhe simboli.

Teknikat e ndryshme narrative (përshkrimi, ligjërata e drejtë, e zhdrejtë, e zhdrejtë e lirë etj)

Retorika dhe figurat letrare

Sistemi i vjershërimit

##### *Pjesa e tretë:*

Gjinitë letrare dhe teoritë e reja

Teoritë e recepsionit.

#### **Bibliografi:**

La Théorie littéraire – René Wellek et Austin Waren

Poétique des textes – Jean Milly-Nattan

Theorie de la littérature – Tzvetan Todorov

Cikël leksionesh përgatitur nga titullarja e lëndës.

### **02. Morfologji e Gjuhës B (2)**

#### **Objektivat e kursit:**

Në këtë modul do të mësohet në përvetësimin sa më cilësor të foljes që përbën bërthamën e fjalisë.

#### **Programi:**

Folja – bërthama e fjalisë.  
Kategoritë themelore të foljes.  
Përdorimi i foljes me vlera të ndryshme.

**Bibliografi:**

Grevisse M. – *Le bon usage*, 13-ème édition, Duculot, 1993.  
Riegel M. Pellat J.Ch. Rioul R. – *Grammaire et méthodologie du français*, PUF, 1994.  
Wagner R.-L. Pinchon J. – *Grammaire du français classique et moderne*, Hachette, 1962.

**03. Tipologji tekstore(2)**

**Objektivat e kursit:**

Të mësohen studentët të analizojnë në mënyrë lineare dhe të strukturuar, duke u përqëndruar tek forma pa u shkëputur nga përmbajtja, duke vënë në shërbim të studentëve tekste të ndryshme, pragmatike, letrare (përshkruese, argumentuese, shpjeguese etj.) autorësh të njohur dhe bashkëkohorë.

**Programi:**

Leximi logjik dhe rëndësia e tij  
Hyrja dhe përpilimi i saj  
Përcaktimi i temës madhore  
Zbërthimi i ideve kryesore  
Përcaktimi i poleve organizative  
Hartimi i planit të hollësishëm  
Konkluzioni dhe përpilimi i tij

**Bibliografi:**

Cikël leksionesh përgatitur nga titullari i lëndës

**04. Histori e gjuhës B**

**Objektivat e kursit:**

Kursi i leksioneve të Historisë së Francës synon të paraqesë një kronologji solide, një sintezë të ngjarjeve kryesore nga Antikiteti të Franca aktuale në një sfond të pasuruar me elementë civilizimi dhe kulturore.

**Programi:**

Kalim i shpejtë nga Antikiteti të Franca Mesjetare.  
Revolucioni i madh borgjez dhe fundi i Regjimit të vjetër.  
Franca napolioniane dhe Republika e dytë.  
Franca nga dy luftrat botërore deri në ditët e sotme.

**Bibliografi:**

*Histoire de la civilisation française*  
G.Duby, R Mandron. Col. Armand & Colin  
*Histoire de la France*  
Cikël leksionesh përgatitur nga titullari i lëndës

## **05. Gjuhë C (3)**

### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs ka për qëllim t'u japë studentëve elementët e nevojshëm të gjuhës se huaj sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve (sipas niveleve A1, A2, B1, B2, C1, C2).

### **Programi:**

#### *Dëgjimi*

Nxënësit shprehin kuptimin e dialogëve dhe mesazheve të reja, të përcjella me gjuhë të thjeshtë, duke reaguar ndaj pikave kryesore dhe hollësive të rëndësishme. Po ashtu shprehin kuptimin gjithnjë e më thellë të një informacioni gojor të panjohur për shoqërinë bashkëkohore në vendin e gjuhës që mësohet.

#### *Të folurit*

Nxënësit marrin pjesë në biseda të shkurtra, duke kërkuar dhe përcjellë informacion, duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve për përjetime të parakohshme e aktuale dhe planë të ardhshme. Nxënësit flasin për tekste e tema të panjohura për të vendosur lidhje me të tjerët, për të shprehur ndjenja, dëshira, për të kërkuar dhe ofruar informacion.

#### *Të lexuarit*

Nxënësit shprehin kuptimin e teksteve të plota më të shkurtra që ngërthejnë një fjalor të njohur dhe rrëfejnë ngjarje të kaluara, të tanishme, të ardhshme. Nxënësit shquajnë pikat kryesore në materialet autentike me një fjalor të panjohur, ata i kuptojnë gjithnjë e më mirë shkrimet për shoqërinë bashkëkohore në vendin e gjuhës që mësohet.

#### *Të shkruarit*

Nxënësit lidhin fjali me paragrafë për të përcjellë të dhëna e mendime që kanë të bëjnë me ngjarje të kaluara, të tanishme dhe të ardhshme. Nxënësit shkruajnë përshkrime faktike dhe hartime krijuese për përjetimet vetjake duke përdorur fjalorin dhe sintaksën e përshtatshme për një regjistër të veçantë.

### **Bibliografi**

## **06. Stilistikë e Gjuhës B**

### **Objektivat e kursit:**

Lënda synon një studim sistematik të nocioneve themelore të stilit, si edhe veçorive stilistiko-shprehëse të gjuhës frënge.

### **Programi:**

Lënda i njeh studentët me parimet bazë të klasifikimit stilistik të leksikut të gjuhës frënge si edhe me aspektet stilistike të fakteve gramatikore. Lënda është e një karakteri më shumë praktik dhe synon ta ndërjegjësojë studentin me veçoritë stilistike të frëngjishte duke bërë shpesh ballafaqime me gjuhën shqipe. Së fundi, pas një njohje të plotë të teorive të sotme për studimet stilistikore, studenti, nën udhëheqjen e pedagogut realizon disa analiza stilistike të teksteve të ndryshëm.

### **Bibliografi:**

Guiraud, La Stylistique, PUF, 1994.  
D. Hadaj, La Stylistique Française, SH.B.L.U., 1980.  
D. Hadaj, Teknika të të shprehurit në gjuhën frënge, SH.B.L.U., 2003.  
Cikël leksionesh përgatitur nga titullari i lëndës

## **07. Hyrje në teorinë e komunikimit**

### **Objektivat e kursit:**

Programi synon dhënien e koncepteve bazë të teorisë së komunikimit.

### **Programi:**

Programi jep konceptet bazë të teorisë së komunikimit, duke u përqendruar në shumëllojshmërinë e tij në kohën e sotme. Ai e njeh studentin me shkollat e ndryshme të komunikimit, veçoritë që ato paraqesin dhe ndihmesën e tyre në analizën shkencore të mjeteve të komunikimit.

### **Bibliografi:**

Henri Boyer, *La Communication*, Presse Universitaire de Grenoble, 1996.  
Baylon, *La Communication*,  
Cikël leksionesh përgatitur nga titullari i lëndës

## **08. Lëndë me përzgjedhje**

### **01. Latinisht**

#### **Objektivat e kursit:**

Kursi synon t'u japë studentëve njohuritë mbi autorët, shkrimtarët dhe poetët kryesorë të gjuhës latine dhe veprat më madhore të tyre, të cilat kanë vënë bazat e letërsisë botërore në të gjitha gjinitë e saj; gjithashtu synon t'u japë studentëve njohuritë e para të plota të fonetikës dhe të morfologjisë, të konkretizuara këto me pjesë të ndryshme letrare që janë të përzgjedhura brenda tekstit.

#### **Programi:**

Hyrje në historinë e letërsisë që nga antikiteti shek. V p.e.r, deri në periudhën imperiale të vonë shek. IV e.r.

Fonetika : shqiptimi i shkronjave; theksimi dhe ndarja e fjalëve në rrokje; Morfologjia : emri, pesë lakimet e tij; folja, katër zgjedhimet e saja, trajta veprare dhe pësore; mbiemri, lakimet dhe shkallët e tij; ndajfolja, shkallët e saja; numërorët; parafjalët

#### **Bibliografi:**

Eliana Paço, *Letërsia dhe gjuha latine*, Turdiu, Tiranë, 2009.  
Kosta Qiriazati, *Gjuha latine*, Shblu, Tiranë, 1989.  
Ëngjëll Sedaj, *Tekste latine*, Prishtinë 1999.  
*Gjuha latine* (tekst për shkollën e mesme), Prishtinë, 1999.

Maurice Rat, *Aide – mémoire de Latin*. Fernand Nathan, Paris, 1983.  
Benedetto Riposati, *Disegno storico della Letteratura Latina*, Società editrice “Dante Alighieri”, 1980.  
Companini Carboni, *Sentenze, motti, proverbi latini*, Paravia, 1993.  
Antonia Piva, Giovanni Sega, Orietta di Bucci Felicetti, *Est modus 3 (storia, generi e autori della letteratura Latina dall’età imperiale al-l’umanesimo)*.  
Akademia e Shkencave e RPSH, *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984.

## **02. Gjuhë D**

**Objektivat e kursit:** Ky kurs ka për qëllim t’u japë studentëve elementët e nevojshëm të gjuhës se huaj sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve (sipas niveleve A1, A2, B1, B2, C1, C2).

### **Programi:**

#### *Dëgjimi*

Nxënësit shprehin kuptimin duke reaguuar ndaj urdhrave, pyetjeve ose pohimeve të shkurtra e të thjeshta që shqiptohen në kushtet e klasës. Si edhe duke reaguuar drejtpërdrejt ndaj udhëzimeve dhe urdhrave të përcjella gojarisht me fjali të thjeshta nga situata dhe tema të përditshme dhe me shpejtësi pothuaj normale

#### *Të folurit*

Nxënësit arrijnë ti shqiptojnë fjalët në mënyrë të përafërt me mbështetje gojore, ose vizuale dhe të reagojnë me faza të shkurtra ndaj shtysave të klasës, duke emërtuar ose përshkruar njerëz, vende, objekte apo situata.

#### *Të lexuarit*

Nxënësit shprehin kuptimin e fjalëve të veçanta, duke ua përshtatur tingujt germave dhe duke lexuar me zë të lartë fjalë dhe fraza të njohura të veçanta. Nxënësit shprehin kuptimin e teksteve dhe dialogëve të shkurtër, të ndërtuar me një fjalor të njohur.

#### *Të shkruarit*

Nxënësit kopjojnë saktë fjalë ose fraza të shkurtra të njohura, etiketojnë objekte rrethanore, dallojnë dhe përzgjedhin fjalë të përshtatshme për të plotësuar togfjalësh. Nxënësit shkruajnë me ortografi të kuptueshme fraza të ngulitura për tema të njohura.

### **Bibliografi:**

## **03. Leksikografi**

### **Objektivat e kursit:**

Kursi i leksioneve në Leksikografi synon të japë nocionet bazë të kësaj fushë duke u përqëndruar më në detaje në problemet që përfshin hartimi i një fjalori si dhe përdorimi i tij.

### **Programi:**

Leksikografia si pjesë e leksikologjisë.  
Nocionet e leksikografisë.  
Tipet e ndryshëm të fjalorëve.

### **Bibliografi:**

*Introduction à la lexicographie:* J. DUBOIS  
*Introduction à la lexicologie:* N. VARFI

#### **04. Letërsi e kulturë Frankofone**

##### **Objektivat e kursit:**

Të pajisë studentët me njohuri të thelluara mbi zhvillimet letrare më të qenësishme të letërsisë bashkëkohore

##### **Programi:**

Romani modern dhe teknikat e reja romaneske  
Poezia moderne dhe veçori të saj

##### **Bibliografi:**

P. Brunel, Histoire de la littérature française, T 2, Bordas  
R. Sabatier, La Poésie du XXe siècle, T 1, 2, 3  
Cikël leksionesh përgatitur nga titullari i lëndës

#### **05. Hyrje në historinë e institucioneve ndërkombëtare**

##### **Objektivat e kursit:**

Kjo lëndë synon të pajisë studentet me njohuritë bazë të institucioneve të arenës ndërkombëtare, kryesisht të aktorëve kryesorë të marrëdhënieve ndërshtetërore - organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare dhe organizatave ndërkombëtarë joqeveritare. Studentët do të kenë rastin të njihen me natyrën, rolet, funksionet si dhe veprimin konkret të këtyre organizatave në raportet e ndryshme mes grupeve të caktuara të interesit.

##### **Programi:**

Hyrje në historinë e institucioneve ndërkombëtare të para në këndvështrime: politike, juridike, ekonomike;  
Shoqëria Ndërkombëtare: përbërësit dhe raportet mes tyre; Individit dhe shteti në shoqërinë ndërkombëtare;  
Institucionalizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe rregullat përkatëse të marrëdhënieve mes institucioneve;  
Organizatat Ndërkombëtare ndërqeveritare universale me karakter politik, ekonomik, ushtarak (KE, BE, OKB, NATO etj)  
Organizatat ndërkombëtare joqeveritare që kanë në vëmendjen e tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, asistencën ndaj fatkeqësive, çështjet mjedisore etj (Kryqi i Kuq, Green Peace, Amnesty International etj);  
